# DËSHMI ARKIVI

**A-453090**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Do martoheshin”/ 34-vjeçarja përgënjeshtron Zegjine Çaushin dhe sqaron foton e publikuar: Unë me at ë, kurrën e kurrës! Më kërcënoi |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/do-martoheshin-34-vjecarja-pergenjeshtron-zegjine-aushin-dhe-sqaron-f-i104705` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | unreachable |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 17:38:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 17:32:08 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `24947cb30dbf68d6ec81278885bc42b78a5b9e4fb5e82ac423cf9976ba62d8ee` |
| TEKSTI | `4bc785612f60304d8992565711561b713ee4ee7c0281da1ea0622260f503cfa1` |
| PAMJA | `2b74d58642d88d40811cdc4e96aeba1eac9217f5821803e17c743bedfb2bf08f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2734786092b15d7082378d144af830a73b1cfcd4920b6ed4288ddd100a9f1937` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2734786092b15d7082378d144af830a73b1cfcd4920b6ed4288ddd100a9f1937`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# “Do martoheshin”/ 34-vjeçarja përgënjeshtron Zegjine Çaushin dhe sqaron foton e publikuar: Unë me atë, kurrën e kurrës! Më kërcënoi

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 19:32



34-vjeçarja, Merita Gremaj ka hedhur poshtë deklaratën e deputetes së Partisë Socialiste, Zegjine Çaushi, se ajo dhe daja i saj, Bledar Bakaj, do të martoheshin. Duke folur në “Shqipëreia Live”, Merita Gremaj ka mohuar se ka pasur plane për tu martuar me Bledar Bakajn, duke deklaruar se kurrën e kurrës nuk do të martohej me të. Ajo sqaroi se fotografia e publikuar nga deputetja ishte bërë në Fier, gjatë një daljeje për të blerë rroba dhe sipas saj fotografia ishte përdorur në një situatë ku Bakaj e kërcënonte.

Gremaj tha se kishte përjetuar dhunë dhe kërcënime të vazhdueshme dhe se nuk e kishte denoncuar më herët nga frika. Sipas saj, Bakaj e kishte kërcënuar se do t’i hiqte një këmbë dhe një krah nëse fliste. Ajo tregoi se kishte dorëzuar prova në polici dhe se kërcënimet, sipas saj, kishin vazhduar edhe në shtëpinë e familjes.

Gremaj tha gjithashtu se nuk kishte pasur kontakte me deputeten pas denoncimit, ndërsa familjarë të Bakajt, sipas saj, i kishin kërkuar të tërhiqte denoncimin, duke i thënë se ai kishte fëmijë. Në fund, ajo shpreh shqetësim për gjendjen e babait të saj, i cili ndodhet në shtrat pasi 52-vjeçari e ka plagosur me drapër. E reja thekson se edhe nëna e saj është në gjendje shumë të rënduar.

**Sidorela Gjoni:** A do të martoheshit, cila është e vërteta?

**Merita Gremaj:** Unë me atë, kurrën e kurrës

**Sidorela Gjoni:** Kur është bërë foto?

**Merita Gremaj:** Kur kemi ikur në Fier me ble rroba. Si mund të merrem me një njeri që më dhunon, kërcënon, më keqtrajton

**Sidorela Gjoni:** Kush t’i ka dhuruar?

**Merita Gremaj:** Mi ka dhënë vajza e Nazmies. Foto është bërë se më kërcënonte

**Sidorela Gjoni:** I ke thënë deputetes se do martohesh?

**Merita Gremaj:** Jo, unë e kam nxjerrë jashtë. Donte Bledari të më fuste në punë dhe ajo thoshte në Roskovec.

**Nexhi Beqiraj:** Pse nuk e keni denoncuar, të kërcënonte dhe nuk e ke denoncuar?

**Merita Gremaj:** Se thoshte ti po tregove do të të heq një këmbë dhe krah, do të bëj të vuash, e ka thënë edhe në komisariat.

**Sidorela Gjoni:** Kur është bërë fotografia?

**Merita Gremaj:** Në muajin qershor

**Sidorela Gjoni:** Të këtij viti?

**Eris Dhamo:** Kur ka nisur dhuna për herë të parë?

**Merita Gremaj:** Ka qenë e vazhdueshme

**Sidorela Gjoni:** Edhe në qershor?

**Merita Gremaj:** Vetëm dy ditët e fundit e ndali dhunën se erdha në shtëpi për të kërkuar ndihmë, te familja ime

**Sidorela Gjoni:**Si reaguan institucionet kur bëre denoncimin?

**Merita Gremaj:** Më thanë ‘pse nuk erdhe më para?’. Po nuk kisha shanse

**Sidorela Gjoni:** Cilat janë provat që ke?

**Merita Gremaj:** Kam një telefon tjetër dhe ky akoma vazhdon me kërcënime edhe në shtëpinë time. Atje nuk kam mundur t'a regjistroj se nuk kisha telefon.

**Sidorela Gjoni:**Në polici ça provash ke dhënë?

**Merita Gremaj:** Kam dhënë prova. Unë faktikisht si person nuk doja kontradikta, se gjerat më shumë agravoheshin

**Sidorela Gjoni:**A të ka marrë deputetja në telefon?

**Merita Gremaj:** Erdhi bashkë me babain e saj dhe solli vetëm rroba

**Sidorela Gjoni:** Pas denoncimit?

**Merita Gremaj:** Jo. S'kam kontakte, s'më ka marrë, asnjë takim

**Sidorela Gjoni:** Po të afërmit e Bledarit?

**Merita Gremaj:** Më kanë thënë të heq denoncimin se ka fëmijë, nuk mundem se jam e kërcënuar dhe e dhunuar. Po tani që babai im ndodhet në shtrat ca të bëj. Unë dhe nëna jemi si mos më keq./**Dosja.al**

merita gremaj | bledar bakaj | zegjine Çaushi

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 17 Shtator19:04

**Falsifikoi 1143 hektarë në Fier/ Prokuroria jep urdhër për arrestimin e Kastriot Haskos, detaje nga dosja**

Me kërkesë të Prokurorisë së Fierit, është vënë në pranga sot Kastriot Hasko, i akuzuar si përfituesi i p...

AKTUALITET 17 Shtator18:58

**SPAK nis hetimet për pagat e magjistratëve, sekuestron praktikat te Ministria e Financave**

SPAK ka nisur hetimet për çështjet e pagave të gjyqtarëve. Prokuroria e Posaçme ka sekuestruar praktikat te Financat. Drejtue...

AKTUALITET 17 Shtator18:41

**Zbardhet vendimi i plotë i gjykatës, si u zbulua vila e dytë e Ballukut**

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur sekuestrimin preventiv të një vile në kompleksin &ldq...

AKTUALITET 17 Shtator17:37

**"Revolucioni i Flamingove" nuk ndalet, përplasje me policinë dhe shoqërime**

Protestuesit nisën të mblidheshin rreth orës 10:00 pranë godinës së Kuvendit, pak përpara fillimit të seancës plena...

AKTUALITET 17 Shtator17:29

**Shkodër/ Bypass pa ndriçim natën, banorët: Kalimi i rrugës i rrezikshëm**

Sistemi i ndriçimit në Bypass-in e Shkodrës ndodhet në gjendje degradimi prej kohësh, duke lënë pjesën më të...

AKTUALITET 17 Shtator17:10

**Aeroporti i Vlorës/ MIE: Arbitrazhi i Emergjencës rrëzon kërkesat kryesore të VIA-s! Nuk pranon të pezullojë zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka bërë me dije se Arbitrazhi i Emergjencës ka rrëzuar kërkesat kryesore t&eum...

AKTUALITET 17 Shtator16:28

**Velipojë/ Pësoi arrest kardiak pasi u fut në det, humb jetën pushuesi nga Kosova**

Një i moshuar nga Kosova ka humbur jetën sot në plazhin e Velipojës. Policia bën me dije rreth orës 15:30, në zonën e &...

AKTUALITET 17 Shtator16:25

**Daja i deputetes së PS e rrahu dhe i plagosi me drapër të atin, 34-vjeçarja sqaron foton e publikuar nga Zegjine Çaushit: Ja si qëndron e vërteta**

Sot u mbajt seanca për Bledar Bakajn, dajën e deputetes së PS-së, Zegjine Çaushit, ku u vendos masa e sigurisë "Arrest me ...

AKTUALITET 17 Shtator15:52

**Çmimi i lartë i naftës, hyn në fuqi vendimi për rikthimin e Bordit të Transparencës! Pritet edhe ulja me 20% të akcizës!**

Ka hyrë sot në fuqi vendimi për rikthimin e Bordit të Transparecës, tre muaj pasi u shpërnda. Rikthimi i Bordit të Transparec...

AKTUALITET 17 Shtator15:45

**Nga 446 mijë në 511 mijë lekë/ Sa paguhen sot magjistratët dhe cfarë kërkojnë KLGJ e KLP**

Pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë kthyer në një nga përplasjet më të forta mes institucioneve, pas kërkes&eum...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

**Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...**

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

**VIDEO- Dy aksidente me pesë viktima/ Prezantues...**

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

LIFESTYLE 16 Shtator

**Prishtinë/ Shqiptarët protestojnë kundër vendim...**

Ndërkohë që në rrugët e Prishtinës po zhvillohen protesta e tubime lidhur me vendimin e Gjykatës Speciale të Hagës ...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

**Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues**

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

## video



### E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV



**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.